



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI

VENDIM

Nr. 4, datë 08.03.2018

"PËR

**REDUKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50% PËR STUDENTËT QË NDJEKIN NJË PROGRAM NË CIKLIN E DYTË TE STUDIMEVE DHE QË I PËRKASIN KATEGORIVE SOCIALE NË NEVOJË PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018"**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 2, 3 pika c/ç, shkresën nr. 5171 prot, datë 17.05.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe me propozim të Administratorit të Institucionit, Senati i UPT,

VENDOSI:

1. Të miratojë reduktimin e tarifës së shkollimit për studentët që ndjekin një program në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave", në masën 50 %, për vitin akademik 2017 – 2018 për kategoritë e individëve si më poshtë:
  - Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me Vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);
  - Studentët, fëmijë të personave me aftësi të kufizuara të vërtetuara me KMCAP;
  - Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
  - Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të pamjaftueshme për të përballuar koston e studimeve;
  - Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
  - Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjyqësor të formës së prerë;

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI**

- Studentët deri në moshën 25 vjeç që janë identifikuar si viktime të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të qënieve njerëzore;
  - Studentët, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror, dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes;
  - Studentët romë dhe ballkano – egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale, si dhe;
  - Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.
2. Ti propozojë Bordit të Administrimit miratimin për reduktimin e tarifës së shkollimit për studentët që ndjekin një program në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave", në masën 50 %, për kategoritë e individëve të përcaktuara në piken 1.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Prof. Dr. Andrea MALIQARI**

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al